



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE**

Nr.9602 Akti

Nr. 7191 VENDIMI

**V E N D I M**

**“ NE EMER TE REPUBLIKES “**

**Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga :**

**Gjyqtare - Fiqirete Mullaj**

asistuar prej sekretares gjyqesore Monika Thanasi, sot me date 13.12.2006, mori ne shqyrtim ne seance gjyqsore publike, çeshtjen civile me nr Akti 9602, me pale nderrgjyqese :

**KERKUES**

- Shqiponja Hoxha, e bija e Hasanit dhe Meleqes, e datl 19.12.1968, lindur dhe banuese ne Tirane, perfaqesuar me deklarim nga avokati Besnik Cerekja.

**O B J E K T I** -

- Dhenie autorizimi, per shitje te pasurise se paluajteshme per femijet e mitur Miger Hoxha i datl.10.08.1996 dhe Klevi Hoxha i datl.17.02.1999

**BAZA LIGJORE** - Neni 234 i Kodit te Familjes.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te pales kerkuese u kerkua pranimi i kerkeses

Gjykata pasi administroi provat e nevojshme, e si e bisedoi ceshtjen ne teresi:

**V E R E N**

Kerkuesja Shqiponja Hoxha, me kerke drejtuar gjykates ka kerkuar leshimin e autorizimit, per tjetersim (shitjen e pasurise) ne emer te

femijeve te mitur, Miger Hoxha i datl. 10.08.1996 dhe Klevi Hoxha i datl. 17.02.1999.

U vertetua ne gjykim se kerkuesi Shqiponja Hoxha eshte e ve dhe nga martesa ka dy femije te mitur, te quajtur Miger Hoxha i datl. 10.08.1996 dhe Klevi Hoxha e datl. 17.02.1999.

Sipas vendimit te gjykates nr.4472 date 07.07.2005 kerkuesja dhe femijet e saj te mitur, jane trashegimtare ligjore te radhes se pare te trashegimlenesit Eduard Hoxha dhe bashkepronare te pasurive qe figurojne ne emer te tij dhe respektivisht kuotat e shoqerive "TISA" sh.p.k., "EL-ALBA TRANS" sh.p.k. dhe "EL-ALBA 1" sh.p.k.

Duke pare nevojen gjithmone ne rritje te femijes se mitur, per kushte sa me te mira jetese, banimi ashtu dhe shkollimi, kerkuesja kerkon te shesi kete pjese te kuotave te kapitalit te ketyre shoqerive qe kane ne pronesi.

Meqenese femijet jane te mitur dhe meqenese veprimet qe do te kryen kaperxejne kufijte e nje administrimi te thjeshte te cdo pasurie te te miturit, kerkohet leshimi i autorizimit.

Gjkata cmon se jane te gjitha kushtet, per leshimin e autorizimit, per tjetersim pasurie.

Sipas nenit 234 te K.Familjes:

"Tjetersimi i pasurise se paluejtshme te cdo femije te mitur deri ne moshen 18 vjec, lenie hipoteke..... si dhe perqjithesish veprimet qe kapercejne kufijte e nje administrimi te thjeshte te cdo pasurie te te miturit mund te kryhen kur e kerkon interesi i te miturit dhe me autorizim te Gjykates..."

Edhe ne rastin konkret, shitja e pasurise se perbashket, favorizon te miturit ne permiresimin e kushteve te banimit dhe per shkollim.

Persa me lart, kerkesa e kerkueses Shqiponja Hoxha, eshte e mbeshtetur ne ligj e prova dhe si e tille duhet te pranohet. Si rrjedhoje duhet te leshohet autorizimi per tjetersim (shitjen) e kuotat te shoqerive "TISA" sh.p.k., "EL-ALBA TRANS" sh.p.k. dhe "EL-ALBA1" sh.p.k, ku femijet e mitur, Miger Hoxha I datl. 10.08.1996 dhe Klevi Hoxha i datl. 17.02.1999 jane bashkepronare ne pjese te pandare mbi kete prone.

#### PER KETO ARSYE

Gjkata, bazuar ne nenet 126 dhe 306 e vijues te K.Pr.Civile

:

## V E N D O S I

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Shqiponja Hoxha.  
Leshimin e autorizimit per tjetersim (shitjen e kuotave qe I  
ndjeri Eduard Hoxha dispononte prane shoqerive "TISA"  
sh.p.k., "EL-ALBA TRANS" sh.p.k. dhe  
"EL-ALBA1" sh.p.k, ku femijet e mitur, Miger Hoxha i  
datl.10.08.1996 dhe Klevi Hoxha i datl. 17.02.1999 kane  
trasheguar ne baze te vendimit nr 4472 date 07.07.2005.  
Shpenzimet gjyqsore i takojne kerkuesit.  
Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatene Apelit  
Tirane brenda 15 – diteve, duke filluar ky afat nga e  
nesermja e shpalljes.  
U shpall, sot ne Tirane me date 13.12.2006

S E K R E T A R E  
MONIKA THANASI

G J Y Q T A R E  
FIQIRETE MULLAJ

SHPENZIME GJYQESORE  
Takse Pulle 100 Leke

16.01.2007  
12.000  
100 LEKE

KANCELARI

MIR SAULI

PUBLE TAKSE  
100 LEKE  
R. H. P. R. P. S.